

## EPIKA HISTORIKE DHE KORRESPONDIMI I SAJ ME NGJARJEN HISTORIKE HISTORICAL EPIC AND ITS CORRESPONDENCE WITH THE HISTORICAL EVENT

LEONTINA GEGA-MUSA

Instituti Albanologjik-Prishtinë, Republika e Kosovës

Email: leontina\_gm@hotmail.com

AKTET VI, 5: 528 - 532, 2013

### PERMBLEDHJE

Kujtesa historike ekziston në kulturën e të gjithë atyre popujve që i karakterizon një përkushtim ndaj së kaluarës, historisë. Shqiptarët shquhen për një traditë të pasur të kulturës shpirtërore, mu për shkak të aftësisë që kanë pasur për ta rrëfyer e vlerësuar të kaluarën e tyre me një përkushtim të veçantë. Dëshmi e kësaj aftësie është krijimtaria gojore letrare, e cila shquhet nga një llojlloshmëri zhanresh, ndër të cilat edhe këngët që trajtojnë tematikë historike-shoqërore ose këngët epiko historike. Këto krijime gojore, pasqyrojnë artistikisht ndërgjegjen e zgjuar të masave në periudha të caktuara, prandaj ato kanë një vlerë të madhe për të kaluarën tonë. Krijues të ndryshëm gojorë të frymëzuar nga realiteti dhe këndvështrimi i ngjarjeve e situatave, me anë të një komunikimi artistik, siç janë këngët epiko historike, ndihmuan që krijimet e këtilla të bëhen dëshmi historike për ngjarje e persona konkretë, të cilët janë të vërtetuar me fakte e të dhëna historike. Prandaj, kjo formë e komunikimit artistik e dëshmime historike, me anë të fjalës së artit, ruajti kujtesën për përkushtimin vetëmohues dhe sakrificën e individëve të dalluar në luftën e vazhdueshme kundër sundimit të huaj, por edhe të karakteristikave etnopsikologjike të etnisë sonë në periudha të caktuara historike.

**Fjalët çelës:** kënga epiko-historike, ngjarja historike.

### SUMMARY

Historical memory exists in culture of every population which is characterized from a past commitment, history. Albanians are well-known about the rich spiritual tradition of their culture, as a result of their ability to narrate and value their past with a special dedication. Proof of this ability is oral literary creation, which is characterized by a variety of genres, among which songs that address historical-social topics, or epic-historical songs. These oral creations, artistically reflect the cleaver conscience of the masses at a certain time, this is why they have a great value to our past. Different oral interpreters inspired by reality and perspective of different events and situations with an artistic communication, such as epic-historic songs, helped these creations to become historical facts for specific events and persons who are certified with proofs and historical data. Therefore, this form of artistic communication of historical proofs, by the power of art's word, maintained continually historical memory, for selfless dedication and well-known individual sacrifice in the continuing war against foreign occupation, but also the ethno-psychological characteristics of our ethnicity in certain historical periods.

**Key words:** historical epic song, historical event

### Hyrje

Shqiptarët shquhen për një traditë të pasur shpirtërore, të përcjellë me një kujtesë historike nga e kaluara për kulturën e tyre dhe me aftësinë që kanë pasur për ta rrëfyer e vlerësuar atë me një përkushtim të veçantë. Dëshmi e kësaj aftësie

është krijimtaria gojore letrare në përgjithësi, po në veçanti edhe këngët që trajtojnë tematikë historike-shoqërore ose këngët epiko historike. Epika historike, si lloj i krijimeve poetike gojore, është e ndërtuar nga ligjshmëritë e përgjithshme të epikës, por me një trajtim të realitetit historik,

me përmbajtje të një karakteri konciz e me një sintezë ngjarjesh, ku mbisundojnë ide dhe ndjenja të përbashkëta të masës kundër një pushtuesi.

Epika historike e krijimtarisë sonë gojore është e frymëzuar nga ngjarje të rëndësishme, nëpër të cilat ka kaluar formimi ynë si komb. Duke qenë bashkudhëtare e historisë, ajo u bë jehonë artistike e kundërshtive, qëndresave, revoltave, kryengritjeve kundër pushtuesve të ndryshëm, që nga ato të karakterit më lokal e krahinor, e deri në ato të një plani më gjithëpërfshirës kombëtar e ndërkombëtar.

Këto krijime gojore, pasqyrojnë artistikisht ndërgjegjen e zgjuar të masave në periudha të caktuara, prandaj ato kanë një vlerë të madhe për të kaluarën tonë. Krijues të ndryshëm gojorë të frymëzuar nga realiteti dhe këndvështrimi i ngjarjeve e situatave, me anë të një komunikimi artistik, siç janë këngët epiko historike, ndihmuan që krijimet e këtylla të bëhen dëshmi historike për ngjarje e persona konkretë, të cilët janë të vërtetuar me fakte e të dhëna historike. Prandaj, kjo formë e komunikimit artistik e dëshmimeve historike, me anë të fjalës së artit, ruajti kujtesën historike në vazhdimësi, për përkushtimin vetëmohues dhe sakrificën e individëve të dalluar në luftën e vazhdueshme kundër sundimit të huaj, por edhe të karakteristikave etnopsikologjike të etnisë sonë në periudha të caktuara historike.

### **Periodizimi**

Përmbajtja e këngëve epike historike na mundëson një përcaktim kohor të ngjarjeve historike, në bazë të së cilave edhe janë klasifikuar këto këngë në vëllimet e botuara dhe që tani më mund t'i kemi për studim të mëtejshëm si krijime letrare gojore. Ndarja e epikës historike në cikle na mundëson një pasqyrim të memories sonë historike, si dhe ecurinë e formimit të ndërgjegjes sonë kombëtare. Pothuajse të gjitha ciklet e këngëve epike historike, duke filluar nga ato më të hershmet të qëndresës kundër të huajit; të qëndresës kundër osmane të shekullit XV, me këngët kushtuar personaliteteve të shquara të

historisë kombëtare, si Skënderbeut dhe bashkëluftëtarëve të tij; me këngët kushtuar ngjarjeve të shekujve XVI-XVIII; këngët epike historike të ciklit të periudhave të principatave të pavarura shqiptare, si asaj të Bushatasve dhe Ali Pashë Tepelenës; cikli i këngëve rreth Lidhjes shqiptare të Prizrenit e deri në shpalljen e Pavarësisë Kombëtare të vitit 1912, që kanë për tematikë rezistencën kombëtare ndaj pushtuesit osman; gjithashtu cikli i këngëve për ngjarje të ndryshme historike të viteve 1913-1919; 1920-1924 dhe ato të viteve 1925-1939 kundër formave të ndryshme të shtypjes dhe shfrytëzimit; cikli me këngë historike të LNÇ; këtu do të shtoja edhe këngët historike të luftës së fundit për pavarësinë e Kosovës, paraqesin një bashkësi tematike dhe një vazhdimësi që shprehet në lidhje të përcaktuara artistike (E.H.1,1983-11).

Narracioni i hollësishëm në këto krijime na shfaqet si një evokim kujtimesh për ngjarje të ndryshme historike, po edhe si madhëri e figurave të caktuara në ato ngjarje (K.P.H. I,2007-13). Prandaj, rapsodët të frymëzuar nga dramati e konfliktet e mëdha, po edhe nga shembujt e sakrificës dhe trimërisë së denjë të një sërë personalitetesh të shquara të atyre ngjarjeve të shënuara, krijimeve të tyre poetike u dhanë një përjetim emocional e informativ rreth asaj që ka ndodhur me jetën politike-sociale në përputhje me kërkesat shoqërore e kulturore të kohës, dhe krahas fiksimit të ngjarjeve e fakteve historike zgjuan ndjenjat morale, si atdhedashuria e heroizmi. Motivet që frymëzuan rapsodët e këtyre krijimeve poetike gojore kanë një ide të përbashkët atë të konstituimit kombëtar. Prandaj paraqesin një lidhje tematike e organike dhe janë dëshmi të një vullneti të përgjithshëm për realizimin e aspiratave lirishtetërore (E.H.3,1990-7). Këto krijime nga aspekti i strukturës kompozicionale ndryshojnë varësisht nga periudha e caktuar historike dhe dinamika e ngjarjeve, prandaj brenda këngëve historike ka krijime me strukturë të veçantë tregimtare, e paraqitje të hollësishme deri në detaje të ngjarjeve dhe trimërive të individëve të caktuar.

### **Beteja e Kosovës (1389)**

Po që se nisemi nga një parim kronologjik për këtë lloj të krijimtarisë sonë gojore, kënga epiko historike e cila korrenspondon historikisht me ngjarjen më të vjetër të kënduar ndër shqiptarë është ajo e Luftës së Kosovës e vitit 1389. Kjo luftë e cila pati jehonë edhe në krijimtarinë gojore të popujve të tjerë të Ballkanit, në variantet e këngëve shqiptare ka për motiv “vrasjen e sulltan Muratit nga heroit kosovar Millesh Kopiliqi, të cilin kujtesa dhe vetëdija popullore e shqiptarëve të Kosovës e ka identifikuar si një personazh të bashkësisë së vet etnike” (E.H. 1,1983-22).

Me interes për këto këngë kushtuar kësaj beteje mbetet dëshmia e lashtësisë së këtij krijimi dhe këndvështrimi i popullatës shqiptare për të. Gjithashtu, këngët që i kushtohen kësaj beteje, kanë përbërës karakteristike të legjendave autoktone shqiptare, që lidhen me besime e besëtytni të njohura vetëm në traditën tonë, prandaj edhe paraqesin një fazë kalimtare ndërmjet epikës legjendare në atë historike. (K.P.H. I,2007-14)

### **Moti i madh i Arbërit**

Epika jonë historike do të pasurohet më tej me krijime kushtuar heroit tonë kombëtar Skënderbeut, si dhe ngjarjeve e betejave që shënuan shekullin XV në historinë tonë si “Motin e madh të Arbrit”. Dëshmi e ekzistencës dhe lashtësisë së kësaj epike historike mbeten cikli i këngëve për Skënderbeun dhe bashkëluftëtarët e tij të këngëve arbëreshe, të cilat në strukturën e tyre bartin elemente të një tradite arkaike, të natyrshme për faktin se ato u krijuan me format tradicionale ekzistuese të kohës.

Këngët për rrethimin e Krujës, për fitoren e luftës së Albulenës, po edhe këngë të tjera për luftimet e Skënderbeut, Gjergj Arianitit, Vrana Kontit, Tanush Topisë etj., shquhen nga një forcë epike përkushtimi këtyre betejave dhe luftëtarëve të tyre, duke u bërë kështu dëshmi dhe jehonë e ngjarjeve të historisë sonë kombëtare.

Rapsodi, e më vonë edhe shkrimtarë të frymëzuar nga krijimet rapsodike, lartësuan figurën e Skënderbeut në simbol të patriotizmit

dhe mbrojtësit të trojeve arbërore nga pushtuesit e huaj.

### **Sinjalet e ndërgjegjësimit kombëtare**

Prandaj epika historike e kësaj periudhe u bë burim dhe frymëzim edhe për lëvizjet historike në vazhdimësi për çlirim kombëtar, sidomos në periudhën e Rilindjes. Pas një vakumi kohor kënga epike historike shfaqet edhe më e fortë sidomos në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, si një jehonë e ngjarjeve social-politike të kohës. Cikli i këngëve historike të kësaj periudhe mbetet i motivuar kryesisht nga ngjarjet dhe përpjekjet për formimin e pashallëqeve të pavarura, si ajo e Bushatasve në Veri dhe e Ali pashë Tepelenës në Jug, kundruall administratës turke. E veçanta e këngëve historike të kësaj periudhe mbeten elementet e qarta të një ndërgjegjeje patriotike e cila në disa këngë merr hov të drejtpërdrejtë për një organizim të përbashkët të Veriut dhe Jugut kundër pushtuesit osman, si në vargjet: “*Tosk’ e geg’ u lidh besa, / me i dal’ para Osmanllisë*” (E. H. 1,1983-33).

Rapsodi i kushtëzuar nga faktet politiko-sociale dhe nga kërkesat ideoartistike të marrësit, tani më i liron vargjet e krijimeve të kësaj periudhe nga elementet mitike, të fuqisë së mbinatyrshme me mjete fantastike dhe krijimet e tij në vijim korrespondojnë me kërkesat e drejtpërdrejta reale të kohës, siç janë lufta kundër pushtuesit dhe çlirimit ekonomik-shoqëror.

### **Forcimi i vetëdijes kombëtare**

Forcimi i ndjeshmërisë së vetëdijes kombëtare dhe i kuptimit për faktorin Atdhe bëri që këngët historike të shënojnë dallime cilësore artistike në varshmëri të ngjarjes që trajtojnë, ndërkaq heronjtë e këtyre krijimeve të marrin kuptimin simbolik të heroit kombëtar. Kështu këngët historike që u kushtohen ngjarjeve dinamike të periudhës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit janë shfaqje emocionale e thirrjes për mobilizim dhe paraqitjes së heroizmit të përgjithshëm popullor në mbrojtje të trojeve etnike. Disa nga krijimet më të dalluara të kësaj periudhe shquhen për vlerat e veçanta artistike, po edhe për pasqyrimin e ngjarjeve të rëndësishme dhe luftërave të

zhvilluara për mbrojtjen e viseve shqiptare, si ajo e Plavës e Gucisë, e Hotit e Grudës, e Ulqinit, etj. Gjithashtu edhe krijimet për kryengritjet e shqiptarëve në Kosovë në fillim të shekullit XX dëshmuar artistikisht luftën për liri, për krijimin e shtetit kombëtar brenda hapësirave të tij aktuale dhe historike.

### **Dhimbja dhe mallkimi për copëtimin territorial**

Gjithsesi se Shpallja e Pavarësisë së shtetit shqiptar, si akti më sublim dhe kyç në historinë tonë kombëtare, si dhe përpjekja për demokratizimin e pushtetit dhe lufta për çlirimin ekonomik-shoqëror, u bënë motiv për krijime të reja epiko historike të kësaj periudhe. Këngët historike të ciklit të shpalljes së pavarësisë kombëtare, si dhe ato që u kushtohen personaliteteve historike që u bënë simbol të kësaj periudhe, janë krijime të kënduara në përmasa gjithëkombëtare. Krijimet e këtilla, si ato të arritjes së pavarësisë kombëtare, po edhe ato që shprehin dhimbjen kombëtare që krijoi copëtimi i trojeve etnike shqiptare me vendimin e padrejtë në Konferencën e Londrës qenë reflektim i ngjarjeve ku tani më ishin më të qarta konturat historike, gjeografike e sociale të kombit tonë.

Rapsodi e shprehu këtë dhimbje për ngjarjen konkrete me vargjet e këngës historike ku mallkon fuqitë e mëdha për këtë vendim: *“Të mëdhenjt’ paçin belanë, / që e trazuan dynjanë, / mëmëdhen’ më dysh na e ndanë, / Kosovën jashtë na e lanë.”* (E.H. 3,1990-44)

Këngët historike që iu kushtuan personaliteteve historike të cilët u bënë simbole kombëtare të kësaj periudhe, shquhen nga një fuqi poetike e shfaqjes së botës së brendshme të individëve të caktuar, po edhe ndërgjegjes së masës në periudha të caktuara historike. E veçanta e këtyre krijimeve mbetet në përjetësimin e këngës si dëshmi e identitetit etnokulturor, ku spikaten vlerat tona tradicionale, si: besa, mikpritja e burrëria, që mbajnë vlerën e përgjithshme të një identiteti kombëtar. Por, në këto këngë ku shquhen virtytet njerëzore, si vlerë karakteristike e heronjve, qëndron edhe atdhetari si njeri me një botë të pasur shpirtërore, që e plotëson

karakterin e personazhit hero të një kënge historike. Në këto këngë shprehet vendosmëria, gjakftohtësia dhe guximi i këtyre luftëtarëve, ku përmasa hiperbolike në vargje të caktuara, u përdor kryesisht në funksion të mirëfilltë poetik, për të depërtuar sa më thellë në shpirtin e shqetësuar njerëzor dhe jo për të krijuar figura tipike legjendare.

### **Përfundim**

Duke veçuar disa nga kthesat kyçe të historisë sonë, po edhe të dëshmisë së korrespondimit të këtyre ngjarjeve historike me krijimet epiko historike, mund të shtojmë se tani më këto krijime letrare gojore kanë një përmbajtje të dokumentuar ngjarjesh në ambiente të caktuara gjeografike të cilat shquhen për begatinë e madhe tematike e motivore, me një mjeshtri artistike dhe shprehje poetike që frymëzojnë një patriotizëm të madh për atdheun dhe lirinë e tij. Figurat poetike si: simboli, epiteti, hiperbola, krahasimi, antiteza, etj., që ka përdorur rapsodi në këto krijime shtojnë ndjeshmërinë dhe anën emocionale tek marrësi duke shprehur aktualitetin e kohës me një gjuhë poetike. Prandaj, ky lloj krijimesh me këngë epiko historike shquhet nga një ecuri dinamike dhe intensitet komunikimi ngjarjesh në përputhje me realitetin historik. Veçori themelore dalluese e këtyre krijimeve mbetet bashkudhëtimi me historinë, si dhe trajtimi i ngjarjeve dhe i personazheve me një vërtetësi të përcaktuar në kohë dhe në hapësirë. Pra, kujtesa historike shqiptare dëshmohet edhe me krijimtarinë shpirtërore gojore me anë të së cilës rrëfëhet e kaluara jonë, e njëkohësisht edhe vlerësohet.

### **Bibliografia:**

- (1983), *Epika historike 1*, AShSh, IKP, Tiranë.
- (1981), *Epika historike 2*, AShSh, IKP, Tiranë.
- (1990), *Epika historike 3*, AShSh, IKP, Tiranë.
- (2007), *Këngë popullore historike I, II, III, IV*, IAP, Prishtinë.
- SHALA, Demush (1973), *Këngë popullore historike*, ETMM, Prishtinë.
- SYLA, Fazli (1988), *Kënga dhe ngjarja historike*, Rilindja, Prishtinë.

(1978), *Këngë popullore të Rilindjes Kombëtare*, IAP, Prishtinë 1978..